

DEKRET – LIGJE
Mbi
FORMIMIN E KOMUNITETEVE FETARE

Art. 1

Çdo njeri ne Shqipni gëzon lirinë e ndërgjegjes dhe të fesë që dishron; kjo liri është e garantueme me artikujt 5 e 203 të statutit themeltar të Mbretnisë.

Art. 2

Formimi i komuniteteve fetare që kanë për qëllim thjesht ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të besimit, organizimin e naltësimin e këtij konvinsioni asht i lejuem simbas dispozitave të kësaj DEKRET –LIGJE.

Art. 3

Komunitetet fetare janë persona moralë, dhe gëzojnë të gjitha të drejtat relative me këtë personalitet në konformitet me këtë Dekret – Ligj, dhe me ligjet e tjera të Shtetit; por këto nuk mund të ndjekin qëllime politike as drejtë për drejtë, as tërthurazi; gjithshu nuk munden me ushtruar të drejtë gjykimi (juridiksioni) për asnji çështje.

Art. 4

Komunitetet fetare quhen të formueme dhe gëzojnë të drejtat e akordueme prej ligjës, vetëm kur Statuti i paraqitun prej tyre, aprovohet prej Këshillit Ministrues dhe dekretohet nga Mbreti. Deri në të kryemit e këtyne formaliteteve mbrenda afatit të përcaktuem prej kësaj Dekret-Ligje, situata juridike e tyre regjohet me ligjet e ma parshme.

Statuti i një komuniteti mund ti paraqitet Qeverisë për aprovim mbasi të jetë votuem e aprovuem prej Asambles ose prej autoritetit kompetent si mbas rregullave kanonike të Komunitetit respektiv.

Art. 5

Ç’do statut i komunitetit fetar i dekretuem simbas artikullit 4 të kësaj Dekret – Ligje, formon detyrimin ligjues dhe zbatimi i tyre sigurohet nga ana e Qeverisë përsa përcaktojnë ligjet e Shtetit.

Art. 6

Kryetarët e ç’do Komuniteti, para se të dekretohen prej Mbretit, gjithashtu edhe të gjithë funksionarët e tjerë para se të legalizohen simbas Statutit të Komunitetit në të cilin bëjnë pjesë nuk mund të fillojnë dhe t’ushtrojnë detyrat e tyre. Për ndryshe si këta ashtu dhe ata, që tue qenë të pushuem vazhdojnë n’ushtrim, ndëshkohen simbas nenit 213 të Kodit Penal.

Art. 7

Kryetarët e feve ashtu dhe subalternët imediat të tyre, dhe ndihmësit e zevendësit e këtyne duhet te jenë shtetas dhe prej fisit e prej gjuhës shqiptare, të dinë me shkruar e këndue lirisht gjuhën zyrtare dhe të jenë në një moshë të paktën 25 vjetësh, dhe të mos jenë të njoftun në Shqipni për vepra antikombëtare.

Sa për Klerin qi pasojnë subalternët immediate, ndihmësit e zavendësit e tyre, duhet të jenë shtetas Shqiptarë dhe të mos jenë të njoftun për vepra antikombëtare.

Art. 8

Kryetarët e çdo Komuniteti, gjithashtu edhe subalternët immediate të tyre, mbassi të zgjidhen në ba zë të Statutit të tyre, emnohen me Dekret – Mbretnuer.

Posë këtyne mund t'emnohen me Dekret – Mbretnuer edhe funksionarë të tjerë për të cilët Statuti lyp Dekret – Mbretnuer.

Art. 9

Komunitetet Fetare janë të lidhuna me Ministrien e Drejtësisë dhe të gjitha marrëdhajet e tyre me Qeverin kryhen me anën e saj, e cilla ka edhe inspektimin e tyre.

Art.10

Buxhetet dhe rregulloret e komuniteteve nuk mund të hyjnë në fuqitë pa u aprovue nga Ministria e Drejtësisë, e cilla në çdo rast ka të drejtë të kontrollojë gjendjen e t'ardhunave e të pasunive që zotnojnë komunitetet, me anën e një inspektori ose një prokurori të Shtetit, dhe t'u kërkoj llogarinë, të hetojë dhe mënyrën e shpenzimeve të bame dhe të vrejë nëse disponimet e bamuna në favor të tyre ekzekutohen si mbas vullnetit të disponuesit.

Art. 11

E drejta e zotnimit kolektiv dhe e përdorimit të pasunive të dëstinueme për një qëllim bamirës fetar e njerzor qi ka caktue themeluesi i tyre i shkon Komunitetit:

- 1) Kur Asmableja e Komunitetit vendos suprimimin e destinimit të themeluesit për arsye të pranueme dhe prej Qeverisë;
- 2) Kur karakteri ose randësija e qëllimi të themeluesit ka ndryshue aq sa fondacioni nuk i përgjejget ma qëllimit të tij;
- 3) Kur destinimi i caktuem prej themeluesit nuk pajtohet me interesat e Shtetit;
- 4) Kur qëllimi i themeluesit nuk asht ma i realizueshëm.

Në të gjitha këto raste vendimi i Këshillit Ministrues si mbas nenevet 450 e 451 të Kodit civil, si edhe ay i Asambles së Komunitetit i pëlqem prej Ministris së Drejtësisë paraqiten për dekretimi Mbretnuer dhe mbase të dali Dekreti relative i tyre transkriptonet në Zyren e Ipotekavet n'emën të Komunitetit kur i përket një prone, dhe kur i përket njisendit të lejueshëm mjaftohet rregjistrimi i tyre në radhorin e pasunive të luajshme të Komunitetit.

Art. 12

Nuk munden m'u zgjedhë ose m'u emnue funksionarë klerik dhe laik të komuniteteve fetare, ata që janë të dënuem me një ndëshkim kundra lirisë personale për ma shumë se dy vjet dhe kur tue qenë t'emnuem dënohen me këtë ndëshkim, bien nga detyra dhe quhen të ndaluar nga ofiqet e tyre ipso – jure. Gjithashtu nuk mund t'emnoet n'ato ofiqe dhe kur

janë t' emnuem quhen ipso-jure të ndaluem ata që janë të dënuem për faje falsifikimi, vjedhjeje, mashtrim, keq përdorim besimi, atentat kundra zakonevet të mira si dhe ata që njifen si pijaneca ose si lojtarë bixhozi, ose që kundër tyne ka një urrejtje publike ose që janë të njoftun botënisht si të poshtëm.

Art. 13

Të gjithë funksionarët klerikal të Komuniteteve fetare të cdo kategorie qofshin deri sa të ndodhen në shërbim aktiv, nuk kanë të drejtë me votue ose me u zgjedhë për ç' do zgjedhje politike, dhe me u emnue për çdo mision politik. Dhe në rasë që dishrojnë me ushtruar të drejtën e votimit ose të drejtën e zgjedhshmënis të paktën gjashtë muaj para zgjedhjeve duhet të jenë largue nga shërbimi fetar.

Çdo zgjedhje ose votim në kundërshtim me këto dispozita asht null.

Art. 14

Cilësija e klerikalve asht e pa - pajtushme me çdo nënpunsi shtetnore ose komunale, me rrogë ose pa rrogë.

Në rast që një nëpunës shteti ose komune emnohet prej komunitetit të tij fetar në një detyre fetare dhe e pranon mbrenda tri ditëve që prej pranimi të cilësis fetare, detyrohet të japin dorëheqjen, për ndryshe asht i pushuem; dhe qoftë Deputet ose i ngarkuem me mision tjetër politik, rrëzohet nga kjo cilësie.

Art. 15

Funksionarët e Komuniteteve posë rasteve të parapame në Statutin e tyne shkarkohen nga detyrat e tyne:

- 1) Drejtë për drejtë me Dekret – Mbretnuer kur:
 - a) Për arësye politike me randësi qi i përkasin qetësis, ose për sjelljet e tyne qi prishin armonien midis komunitetit që shërbejnë, ose provokojnë konflikte midis komuniteteve të ndryeshme;
 - b) Për shkak ndjekjeje penale të cillat prezumojnë dënimin e tyne me një nga ndëshkimet e tregueme n'art.11;
 - c) Në rasë qi ka ankim nga ana e komunitetit për mungesë në detyrë të cillat i janë ngarkue me Statut ose me rregullore të Komunitetit dhe në rasë qi mbas hetimeve që do të bahen nga Ministrija e Drejtësis ankimet vërtetohen.
- 2) Kur me vendim gjyqi u provohet një shpërdorim detyre ose marrin një dënim për një faj qi poshton randësisht para popullit.
- 3) Kur kërkohet prej Ministris së Drejtësis nga Kryesija e Komunitetit largimi i funksionit për shkak se:
 - a) Funksionari klerik merret me politikë ose tërthorazi përzihet në politikë;
 - b) Kur i munon detyrave qi i ngarkon Statuti ose rregulloret e Komunitetit në të cillin bajnë pjesë, edhe
 - c) Kur funksionarëve u provohet një pianecrie e njoftun botënisht ose një sjellje kundra zakoneve të mira.

Funksionari klerik për shkaqet dhe arësytat të përmenduna në këtë paragraf mundet të pretendojnë të kundërtën o vetë ose me anën e Kryetarit t'atij komuniteti dhe në këtë rast të dy raportet i dërgohen Këshillit të Shtetit i cili vendos definitivisht.

Art. 16

Funksionarët e Komuniteteve për emnimet e të cillëvevet ka dalë Dekret – Mbretnuer nuk mundet të quhen të pushuem pa u revokue ky Dekret.

Art. 17

Komunitetet kanë të drejtë mbrenda dispozitave të caktueme në Statutet e rregulloret e tyre të marin masa disiplinore kundra funksionarëve të komunitetit tue e lajmëruet Ministrin e Drejtësis.

Art. 18

Funksionarët fetar të komuniteteve që në shkallën hierarshike vijnë mbas atyne të caktuem në nenin 8, emnohen, pezullohen dhe pushohen simbas Statutit përkatës tue rujtun të drejtën e rekurimit në këshillat superiorë të tyre por kurdoherë dispozitat e neneve 8, 15, e 16, të kësaj Dekret –Ligje, janë të pa cënueshme.

Art. 19

Në rasë që konstatohet se funksionari fetar ka ba një faj në të kryemit e detyrave të veta i cilli parashikohet në Kodin Penal, dërgohet drejt për drejt në gjyqin kompetent dhe gjykohet për fajin e bamë si mbas dispozitave të kodit penal.

Art. 20

Komunitetet janë të ndalueme me pranue ndihmë prej shteteve te huaj, me çdo formë me ç' do mënyrë që të jetë, posë rasteve të pranueme prej Qeverisë për ndihma që kanë për qëllim vepra filantropike.

Dispozita e paragrafit të parë shtrihet edhe për ndihmat e bamuna prej shtetasve të huaj.

Për liberalitetet filantropike që bahen prej të huajve në favorin e komuniteteve ç' do shumë qi të formojë, dhe për liberalitetet kso dore të bamuna nga shtetasit shqiptarë, kur kalojnë shumën 1000 fr. ari duhet leja e qeverisë në konformitet të nenin 562 të kodit civil.

Art. 21

Komunitetet mund të mbledhin nga besimtarët e tyre, shtetas shqiptar, ndihma fakultative të lejueme prej Qeverisë dhe të parapame në Statutet dhe rregulloret e tyre.

Art. 22

Komunitetet ushtrojnë besimin e tyre lirisht me qetësi dhe në konformitet me zakonet e mira në faltore e në vendet e destinueme për fenë e tyre.

Art. 23

Komunitetet për edukimin e klerit të tyre, në bazë të ligjeve të Shtetit, të Statutit e të rregullores përkatëse mund të çelin shkolla fetare (seminare - medrese).

Art. 24

As kush nuk mund të çeli faltore pa u legalizue si mbas dispozitave të kësaj Dekret – Ligje.

Art. 25

Komunitetet fetare me predikimet e tyre janë të detyruem me dhanë këshilla për me zgjue zhvillimin e ndjenjave atdhetare ndaj besimtarve të tyre e me forcue bashkimin kombtar.

Funkcionimi i organizatave të Komuniteteve fetare do të jetë gjithmonë në baza kombëtare, dhe të gjithë funksionarët do të jenë të njoftun pa përjashtim me sjellje Kombëtare.

Art. 26

Asht e ndalueme veshjave e petkave dhe e shenjave të tjera t'ofiqit fetar dhe qi për këtë cilësi nuk kanë një letër identiteti prej Ministris së Drejtësis. Kundra – vajtësit dënohen simbas nenit 214 të Kodit Penal.

Art. 27

Të gjithë Komunitetet fetare qi ekzistojnë në Shqipni para hymjes në fuqie të kësaj Dekret –Ligje detyrohen mbrenda 6 muajve ç'prej qi kjo hyn në fuqie, me u konformue plotësisht me dispozitat e saja, për ndryshe quhen ipso-jure të përndamuna.

Art. 28

Të gjitha dispozitat e kesaj Dekret–Ligje janë në zbatim dhe në kjoftë se nuk janë të përmenduna ose të përfshime në Statutet e Komuniteteve të ndryshme.

Art. 29

Qendrat e Komuniteteve fetare caktohen me Dekret –Mbretnuer.

Deri sa të dalë Dekreti relative qendrat e Komuniteteve mbeten ku janë.

Art. 30

Ligja mbi Statutin legal të komuniteteve fetare dhe të gjitha dispozitat e ligjeve qi janë në kundërshtim me këtë Dekret –Ligje abrogohen.

Dispozita tranzitore**Art. 31**

Statutet e pregatituna prej Asamblesë së Komuniteteve të pa dekretueme para hymjes në fuqi të kësaj Dekret – Ligje, por që do të aprovohen në bazë të kësaj, në rast qi përmbajnë

dispozita që kundërshtojnë parimet e kësaj Projekt – Ligje, tue u anulue vetëm pikat kundërshtuese hyjnë në veprim pa pasë nevojë për një Kongres të dytë.

Art. 32

Kjo Dekret – Ligjë hynë në fuqi që nga dita e shpalljes.

Art. 33

Trupi ministrues ngarkohet me zbatimin e kësaj Dekret ligje.

Kryeministri e

Ministri i P. Mbrendshme:

K.Kota. d.v.

Ministri i Drejtësis:

H. Delvina. D.v.

Ministri i P. Jashtme

R. Fico. D.v

Ministri i Financave:

M. Tutulani. D.v.

Ministri i P. Botore:

S. Vuçiterni. D.v.

Ministri i Ekonomis Kombetare:

Musa Juka. D.v.

Z O G U T

Mbreti i Shqiptarëve

Mbi propozimin e Kryeministrit nr. 1868 datë 4.VII.929

Si ndigjojë dhe pëlqejë vendimin e Këshillit Ministrues me datë 4.VII.929,

D E K R E T O N

Aprovimin dhe zbatimin e Dekret-Ligjit mbi formimin e Komuniteteve Fetare.

Tiranë, më 9 Korrik 1929.

ZOG. D.v

Vërtetohet se asht një me kopjen e origjimalit

Sekretari I Përgjithshëm I Kryesis së Këshillit Ministrues.